

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00.Nr.85 /2025	Data: 30.04.2025	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit nenit 12, paragrafi 12.2 pika d), nenit 58 paragrafi a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, neni 2 paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, neni 33 paragrafi 33.1 pika 3 nenit 68 paragrafi 68.1 të Statutit të Komunës së Istogut 01.Nr.62/2010, si dhe në bazë të kërkesës me nr. 00.Nr.00-016-39392 të datës 17.10.2024 e parashtruar nga Shoqata Sindikale e Administratës së komunës së Istogut për ndarjen e mjeteve buxhetore për kompensimin e shpenzimeve për shujtat e punëtorëve të komunës së Istogut në mbledhjen e mbajtur më 30.04.2025 mori këtë:

V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR FINANCIMIN E SHUJTAVE PËR PUNËTORET E KOMUNËS SË ISTOGUT

1. Miratohet kërkesa me 00.Nr.00-016-39392 të datës 17.10.2024 e parashtruar nga Shoqata Sindikale e Administratës së komunës së Istogut për ndarjen e mjeteve buxhetore për kompensimin e shpenzimeve për shujtat e punëtorëve/zyrtarëve publik të komunës së Istogut për vitet 2022, 2023, dhe 2024.
2. Shuma e miratuar në mbledhjen e Kuvendit të komunës së Istogut është në vlerë prej 4.50 (katër euro e pesë e dhjetë cent) për ditë pune, dhe atë në mënyrë retroaktive për vitet 2022, 2023 dhe 2024 për të gjithë punëtorët e administratës së komunës së Istogut.
3. Qëllimi i këtij vendimi është, të realizohet pagesa për shujtat e zyrtarëve publik në komunën e Istogut duke vlerësuar edhe situatën financiare të tyre edhe në raport me kategoritë e tjera buxhetore të cilat e realizojnë këtë të drejtë si shfrytëzuese të buxhetit të Kosovës kjo është e bazuar edhe marrë parasysh nivelin e ngritjes së çmimeve dhe inflacionin që ka vështirësuar edhe më shumë gjendjen ekonomike të punëtorëve të komunës së Istogut përball obligimeve familjare dhe jetësore.
4. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NJMBNJ) të përpiloj listën e të gjithë punëtorëve në bazë të pranisë të ditëve në punë, viteve të përcaktuara 2022, 2023 dhe 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e komunës së Istogut që pas përpilimit të listës së të gjithë punëtorëve gjatë viteve paraprake ti kompensoj bazuar në ditët e pranisë në punë të gjithë punëtorët.
6. Ky vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shatë) ditë pas publikimit të tij në web faqen zyrtare të komunës së Istogut.


 REPUBLIKA E KOSOVES, KUVENDI I KOMUNES
 POKREPA I SKUPSTINA OPŠTINE
 REPUBLIC OF KOSOVO, MUNICIPAL ASSEMBLY

Nr./Br. 039-66 Nr. i faq/Br. 01

Data/Datum 07.05.2025
 ISTOG, ISTOK

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Enver Rugova